



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 128, Datë 13.05.2026

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “KOKA & ERGI ENERGY PESHK” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 990/5 prot., datë 11.05.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY PESHK” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “KOKA & ERGI ENERGY PESHK” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 990 prot., datë 26.03.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 99, datë 09.04.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 10.04.2026 dhe 11.04.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 20.04.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 990/3 prot., datë 14.04.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për licencimin e saj, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim. Me e-mailin e datës 28.04.2026, ERE i ka kujtuar shoqërisë depozitimin e informacionit/dokumentacionit të munguar, duke i vendosur bashkëlidhur dhe një kopje të skanuar të shkresës së datës 14.04.2026.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 990/4 prot., datë 28.04.2026, shoqëria ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e aplikimit.
- Nga analizimi i aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “KOKA & ERGI ENERGY PESHK” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “KOKA & ERGI ENERGY PESHK” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrît AHMETI